

ATLAN kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR
(kërkesa nr. 36533/97)
19 qershor 2001

të gjitha provat në bazë të të cilave akuzohet dhe dënohet një person duhet t'i paraqiten dhe të vlerësohen nga gjyqtari i çështjes

I. Faktet kryesore

1. Kërkuesit, Armand Atlan dhe i biri Thierry, të dy shtetas franceze, kanë lindur respektivisht më 1932 dhe 1970. Përpara ngjarjeve që do të përshkruhen më poshtë, të dy ata jetonin në San Paolo, Brazil. Kërkuesi i dytë vdiq më 1998 ndërsa kërkuesi i parë tani jeton në Francë.
2. Më 5 korrik 1991 kërkuesit ishin dënuar në Mbretërinë e Bashkuar për import të paligjshëm të 19 kg kokainë (me një vlerë tregu në atë kohë prej 2-3 milion £) në aeroportin e Heathrow në Londër më 3 nëntor 1990. Kërkuesi i parë u dënua me 18 vjet burg dhe me një urdhër konfiskimi të një shume prej 1 918 489.60 £ që në rast se nuk paguhej konvertohej me 10 vjet burg. Kërkuesi i dytë u dënua me 13 vjet burg dhe u urdhërua të paguajë 6 140.66 £ të konvertueshme në 6 muaj burg.
3. Mbrojtja e kërkuesve gjatë procesit gjyqësor konsistonte në pretendimet se ata ishin tregtarë diamantesh dhe ishin implikuar pa dijeninë e tyre në importimin e drogës nga një person i quajtur Rudi Steiner. Megjithatë, ata nuk kishin asnjë provë që të vërtetonin lidhjen e Z. Steiner me çantën plot me kokainë e cila sipas tyre u ishte dhënë në aeroportin e Heathrow dhe se, gjithmonë sipas tyre, Z. Steiner ishte një informator i autoriteteve doganore dhe tatimore. Në bazë të një ballafaqimi, oficerët doganorë që kishin marrë pjesë në këtë çështje refuzuan qoftë të pohonin apo të mohonin që ata kishin patur një informator. Nga ana tjetër nuk doli në pah asnjë provë që Z. Steiner apo ndonjë informator të ishte përdorur ndaj mbrojtjes dhe as nuk u paraqit përpara gjyqtarit të çështjes dhe gjatë të gjithë procesit akuza mohoi vazhdimisht faktin se kishte në dorë materiale sekrete që kishin të bënin me çështjen.
4. Në pranverë 1994, ndërsa po prisnin vendimin e apelit, kërkuesit mësuuan nga shtypi francez se një oficer sekret i policisë zvicerane, Komisari Cattaneo, kishte shkruar një raport të quajtur "Raporti Mato Grosso", i cili kishte të bënte me hetimet e tij të zhvilluara më 1991 në lidhje me trafikun e drogës ndërmjet Brazilit dhe Europës. Në fillim në vitin 1995 avokati i kërkuesve arriti të shtinte në dorë një kopje të raportit. Raporti në fakt përmendte Rudi Steiner, duke e përshkruar si një nga tre informatorët e rregullt të policive Braziliene, Daneze dhe Franceze. Për të thuhet se kishte interes në gurë të çmuar të vjedhur dhe ishte përzier prej shumë kohësh në trafikun e sasive të mëdha të kokainës të cilat ai mund t'i merrte lehtësisht nga policia braziliene. Kërkuesit i paraqitën akuzës një kopje të raportit, e cila nuk ishte në gjendje të pranonte apo mohonte autenticitetin e tij ose vërtetësinë e përmbajtjes së tij, dhe

përsëri theksoi se nuk kishte asnjë material sekret që të kishte rëndësi për çështjen në fjalë.

5. Kërkuesit shtuan një pretendim tjetër në kërkesën e tyre për apel duke i bashkangjitur asaj edhe kërkesën për t'u lënë të lirë për mbledhjen e provave të reja. Ata insistuan që Raporti Mato Grosso mbështeste pretendimin e tyre gjatë procesit, që Z. Steiner mund të shtinte në dorë lehtësisht gurë të çmuar dhe kokainë dhe se ai gëzonte një marrëdhënie të vjetër me organet e ruajtjes së rendit në Evropë. Në këtë kohë, aty rreth 19 tetorit 1995, akuza njoftoi mbrojtjen se, në kundërshtim me deklaratat e saj të mëparshme, ekzistonte në fakt një material sekret i përdorur në proces, të cilin akuza dëshironte t'ia paraqiste Gjykatës së Apelit në mungesë të kërkuesve ose të avokatëve të tyre. Në vijim akuza iu drejtua *ex parte* Gjykatës së Apelit për një vendim në lidhje me çështjen nëse, në ruajtje nga interesi i publik, ajo kishte të drejtë të mos e bënte të njohur materialin në fjalë. Më 16 shkurt 1997, Gjykata e Apelit vendosi që interesat e drejtësisë nuk kërkonin bërjen të njohur të provave me imunitet nga interesi i publikut dhe më 20 shkurt 1997 hodhi poshtë kërkesën për lirim të kërkuesve në pritje të vendimit të saj në lidhje me thelbin e çështjes.

II. Vendimi i Gjykatës

6. Kërkuesit pretenduar se atyre u ishte mohuar e drejta për një gjykim të drejtë në shkelje të Neneve 6 §§ 1 dhe 3 d) të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

A. Në lidhje me Nenin 6

7. Gjykata, duke iu referuar vendimit të saj në lidhje me çështjen *Rowe dhe Davis kundër Mbretërisë së Bashkuar*¹, vuri në dukje se Neni 6 § 1 kërkonte në parim që autoritetet e ndjekjes penale duhet t'i bëjnë të ditura mbrojtjes të gjitha provat materiale që ato disponojnë në favor ose kundër të akuzuarit. Megjithatë, sipas saj, në disa raste mund të jetë e nevojshme të ruhen disa prova me qëllim që të mbrohen të drejtat themelore të një individi tjetër, si për shembull një informator jeta e të cilit mund të jetë në rrezik, ose të mbrohet një interes i rëndësishëm publik, i tillë si mbajtja sekrete e metodave hetimore të policisë. Një ruajtje e tillë e provave mund të jetë e pranueshme në bazë të Nenit 6 vetëm kur ajo është ngushtësisht e nevojshme dhe vetëm kur vështirësitë që i krijohen mbrojtjes në këtë kuadër kompensohen nga procedurat e ndjekura nga gjykatat.

8. Megjithëse natyra e provave të mbajtura sekret në këtë rast nuk ishte përmendur asnjëherë, rrjedha e ngjarjeve nxori në pah një dyshim të fortë në lidhje me Z. Steiner, me marrëdhëniet e tij me Doganat dhe Tatimet Britanike si dhe rolin e tij në hetimin dhe arrestimin e kërkuesve. Këto të dhëna ishin në fakt thelbësore për mbrojtjen e kërkuesve. Siç e ka shpjeguar edhe në vendimin e lartpërmendur *Rowe dhe Davis kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata ka vlerësuar që gjyqtari i çështjes është në pozitën më komode për të vendosur

¹ Vendim i 16 shkurtit 2000.

nëse bërja e njohur apo jo e provave sekrete do të ishte padrejtësisht e dëmshme për pozitën e mbrojtjes. Mosparaqitja e këtyre provave nga ana e akuzës përpara gjyqtarit të çështjes duke e lejuar atë në këtë mënyrë që të vendoste në lidhje me bërjen e tyre të njohur apo jo, i privonte kërkuesit nga një gjykim i drejtë dhe për këtë arsye përbënte shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës.

B. Në lidhje me Nenin 41

9. Gjykata nuk qe në gjendje të thoshte nëse kërkuesit do të ishin dënuar apo jo nëse kjo shkelje nuk do të kishte ndodhur. Ajo vlerësoi se konstatimi i shkeljes përbënte në vetvete një shpërblim të drejtë të mjaftueshëm për çdo lloj dëmi material ose jo-material që mund të kenë vuajtur kërkuesit. Ajo, nga ana tjetër, u akordoi atyre një shumë prej 15 000 £ në lidhje me pagesat dhe shpenzimet procedurale.